

URDHËR
Nr. 125, datë 23.3.2018

**PËR NJË SHITESË NË ANEKSIN II, “MISH I FRESKËT”, PJESA 1, TË URDHËRIT TË
MINISTRIT NR. 328, DATË 22.11.2011, PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR CERTIFIKIMIN
VETERINAR TË DISA LLOJE KAFSHËSH DHE MISHIT TË FRESKËT TË TYRE,
TË CILAT HYJNË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA SHTETE TË
CAKTUARA, SI DHE NGA TERRITORE TË TJERA NË ADMINISTRIM TË KËTYRE
SHTETEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ

1. Në urdhrin e ministrit nr. 328, datë 22.11.2011, “Për miratimin e rregullores “Mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve””, të ndryshuar, në aneksin II, “Mish i freskët”, pjesa 1, në pikën 2, “Lista e vendeve jashtë Bashkimit Europian, territoreve dhe pjesëve të tyre”, rreshti RS – Serbi, kolona 4, pas fjalës “EQU” shtohet fjala “POR”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi**